



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 93/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.03.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e BOE “IKN” shpk & “Geosat” shpk në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr.REF-23485-05-23-2019, me objekt “*Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja Loti 2*”, me fond limit 10.700.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 12.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: “Gjeokonsult & Co” shpk
Kashar, Kthesa e Kamzës, Pallati Mehillaaj, Kati IV,
Tiranë

Autoriteti kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
“Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë

Subjekt i Interesuar: BOE “Geosat Group” & “IKN” shpk
Deshmoret e 4 Shkurtit, Pallat i ri 19, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II**Rrethanat e çështjes**

II.1. Në datën 23.05.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr.REF-23485-05-23-2019, me objekt “*Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja Loti 2*”, me fond limit 10.700.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 12.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr.1430/2 datë 02.09.2019 rezulton se në datën 05.06.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit), ku rezulton se kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë:

- *Instituti i Konsulencës në Ndërtim “IKN”*
- *Taulant*
- *A&E Engineering*
- *Archnet 360*
- *Nord –Comat*
- *Klodioda*
- *C.E.C Group*
- *Gjeokonsult&Co*
- *Infra Plan*
- *Toëer*

II.3. Në datën 14.06.2019 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, nga ku rezulton se në këtë fazë janë kualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë:

Të kualifikuar

- *Instituti i Konsulencës në Ndërtim “IKN”*
- *Taulant*
- *A&E Engineering*
- *Nord –Comat*
- *Klodioda*
- *Gjeokonsult&Co*
- *Infra Plan*

Të skualifikuar

- *Archnet 360*
- *C.E.C Group*
- *Toëer*

II.4. Në datën 12.07.2019 është zhvilluar faza e dytë e procedurës së prokurimit për dorëzimin e propozime teknike dhe ekonomike.

Operatorët pjesmarrës ishin si më poshtë:

- *Instituti i Konsulencës në Ndërtim “IKN”*
- *Taulant*

- *A&E Engineering*
- *Nord –Comat*
- *Klodioda*
- *Gjeokonsult&Co*
- *Infra Plan*

II.5. Në datën 31.07.219 KVO-ja përfundoi vlerësimin e propozimeve teknike të ofertuesve të kualifikuar si më poshtë:

1. Për operatorin ekonomik A&E Engineering

<i>Anëtari i KVO</i>	<i>Përvoja punë të ngjashme 0-10 pikë</i>	<i>Metodologjia e propozuar 20-30 pikë</i>	<i>Kulaiifkimet e stafit kryesor të propozuar 20-50</i>	<i>Transferimi i njourive nëse kërkohet</i>	<i>Total</i>
<i>1</i>	<i>9</i>	<i>22</i>	<i>30+10</i>		<i>71</i>
<i>2</i>	<i>9</i>	<i>22</i>	<i>30+10</i>		<i>71</i>
<i>3</i>	<i>9</i>	<i>23</i>	<i>30+10</i>		<i>72</i>

Pikë mesatare 71.333 pikë

2. Për operatorin ekonomik Taulant

<i>Anëtari i KVO</i>	<i>Përvoja punë të ngjashme 0-10 pikë</i>	<i>Metodologjia e propozuar 20-30 pikë</i>	<i>Kulaiifkimet e stafit kryesor të propozuar 20-50</i>	<i>Transferimi i njourive nëse kërkohet</i>	<i>Total</i>
<i>1</i>	<i>9</i>	<i>22</i>	<i>31+10</i>		<i>72</i>
<i>2</i>	<i>9</i>	<i>21</i>	<i>31+10</i>		<i>71</i>
<i>3</i>	<i>9</i>	<i>23</i>	<i>31+10</i>		<i>72</i>

Pikë mesatare 71.666 pikë.

3. Për operatorin ekonomik Klodioda

<i>Anëtari i KVO</i>	<i>Përvoja punë të ngjashme</i>	<i>Metodologjia e propozuar 20-30 pikë</i>	<i>Kulaiifkimet e stafit kryesor të</i>	<i>Transferimi i njourive nëse kërkohet</i>	<i>Total</i>
----------------------	---------------------------------	--	---	---	--------------

	<i>0-10 pikë</i>		<i>propozuar 20-50</i>		
<i>1</i>	<i>7</i>	<i>23</i>	<i>31+10</i>		<i>71</i>
<i>2</i>	<i>7</i>	<i>24</i>	<i>32+10</i>		<i>73</i>
<i>3</i>	<i>7</i>	<i>23</i>	<i>31+10</i>		<i>71</i>

Pikë mesatare 71.666 pikë

4. Për operatorin “ Geosat Group”&Instituti i Konsulencës në Ndërtim

<i>Anëtari i KVO</i>	<i>Përvoja punë të ngjashme 0-10 pikë</i>	<i>Metodologjia e propozuar 20-30 pikë</i>	<i>Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar 20-50</i>	<i>Transferimi i njourive nëse kërkohet</i>	<i>Total</i>
<i>1</i>	<i>9</i>	<i>25</i>	<i>30+10</i>		<i>74</i>
<i>2</i>	<i>9</i>	<i>26</i>	<i>30+10</i>		<i>75</i>
<i>3</i>	<i>9</i>	<i>25</i>	<i>30+10</i>		<i>74</i>

Pikë mesatare 74.333 pikë

5. Për operatorin ekonomik Gjeokonsult&Co shpk

<i>Anëtari i KVO</i>	<i>Përvoja punë të ngjashme 0-10 pikë</i>	<i>Metodologjia e propozuar 20-30 pikë</i>	<i>Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar 20-50</i>	<i>Transferimi i njourive nëse kërkohet</i>	<i>Total</i>
<i>1</i>	<i>10</i>	<i>30</i>	<i>45+10</i>		<i>95</i>
<i>2</i>	<i>10</i>	<i>29</i>	<i>44+10</i>		<i>93</i>
<i>3</i>	<i>10</i>	<i>30</i>	<i>47+10</i>		<i>97</i>

Pikë mesatare 95 pikë

6. Për operatorin ekonomik Infra-Plan&PNI-2001

<i>Anëtari i KVO</i>	<i>Përvoja punë të ngjashme</i>	<i>Metodologjia e propozuar 20-30 pikë</i>	<i>Kualifikimet e stafit kryesor të</i>	<i>Transferimi i njourive nëse kërkohet</i>	<i>Total</i>
----------------------	---------------------------------	--	---	---	--------------

	0-10 pikë		propozuar 20-50		
1	8	23	35+10		76
2	8	22	35+10		75
3	8	24	35+10		77

Pikë mesatare 76 pikë

7. Për operatorin ekonomik Nord –Comat

Anëtari i KVO	Përvoja në punë të ngjashme 0-10 pikë	Metodologjia e propozuar 20-30 pikë	Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar 20-50	Transferimi i njësive nëse kërkohet	Total
1	8	20	32+10		70
2	8	20	32+10		70
3	8	20	32+10		71

Pikë mesatare 70.333 pikë

II.6. Në datën 07.08.2019, BOE “Geosat Group”& “Instituti i Konsulencës në Ndërtim” ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vlerësimin në pikë të propozimit të tij teknik duke pretenduar si më poshtë:

- Nisur nga kriteret e vlerësimit të propozimit teknik për zërin Përvoja në punë të ngjashme të Konsulentit BOE “Geosat Group”& “Instituti i Konsulencës në Ndërtim” shpik paraqitur si përvoja në punë të ngjashme kontartat sipas tabelës së mëposhtme dhe duke pasur një vlerë totale të punimeve të ngjashme prej 16,143,654 lekë pa tvsh. Kjo vlerë e kalon disa herë kërkesën e DST ku përvoja e mëparshme në punë të ngjashme duhej në një vlerë jo më të vogël se 38 % e fondit limit. Duke qenë se e përmbushim dhe e tejkalojmë 4 herë kërkesën e DST për përvojë të mëparshme në punë të ngjashme si dhe gjithashtu plotësojmë kërkesat e kapacitetit ekonomik dhe certifikatat e standarteve të cilësisë ISO kërkojmë të dimë se pse nga 10 pikë të mundshme jemi vlerësuar me 9 pikë dhe pse konkurenti ynë Gjeokonsult&CO ka marrë pikët maksimale.

N r	Kontrata	Subjekt i	Viti i përfundim	Investitori	Pjesmarrja në	Vlera e kontratës	Vlera pa tvsh
-----	----------	-----------	------------------	-------------	---------------	-------------------	---------------

			<i>it</i>		<i>përqin dje</i>	<i>pa tvsh</i>	
1	<i>Ndërtim i infrastrukturës rrugore në kompleksin Hamallaj</i>	<i>IKN</i>	<i>Prill 2018</i>	<i>Mane TCI</i>	<i>100%</i>	<i>2,880,000</i>	<i>2,880,000</i>
2	<i>Mbrojtja dhe sistemi i pjesës së poshtme të digës së Qyrsaqit</i>	<i>IKN</i>	<i>Gusht 2018</i>	<i>KESH</i>	<i>70 %</i>	<i>3,172,432</i>	<i>2,220,702</i>
3	<i>Rikualifikim i shatërvanit tek Zogu Zi</i>	<i>IKN</i>	<i>Tetor 2018</i>	<i>Fushë Krujë Cement Factory /përfitues Bashkia Tiranë</i>	<i>100%</i>	<i>2,307,060</i>	<i>2,307,060</i>
4	<i>Ndërtim Rrugor Porto Romano Loti I</i>	<i>Geosat</i>	<i>Shtator 2017</i>	<i>ARRSH</i>	<i>100%</i>	<i>4,900,452</i>	<i>4,900,452</i>
5	<i>Supervizim i rikonstruksionit të rrugës rrethrrrotullim i i doganës – mbikalimi kashar dhe rikonstruksion i i rrugës hyrëse të Elabasanit segmenti Fakulteti Filologjik Unaza e Madhe</i>	<i>Geosat</i>	<i>Shtator 2015</i>	<i>FSHZH</i>	<i>80%</i>	<i>2,900,000</i>	<i>2,320,000</i>
6	<i>Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej</i>	<i>Geosat</i>	<i>Nëntor 2017</i>	<i>Bashkia Tiranë</i>	<i>40%</i>	<i>3,788,600</i>	<i>1,515,440</i>

- *Vlerësimi për Metodologjinë e propozuar gjithashtu është i padrejtë*
Metodologjia e propozuar nga BOE IKN&Geosat është shumë e kompletuar dhe e detajuar duke paraqitur problemet kryesore , rëndësinë e tyre si dhe ka shpjeguar përjasjen teknike që do adaptohet për zgjidhjen e tyre.

Metodologjia e propozuar nga ne përmban informacion të zgjeruar mbi historikun e segmentit pallati me shigjeta-rrethrrrotullimi Shqiponja , informacion mbi Lotin 2 km (0+760÷1+600), Punimet ndërtimore Nyja 2 (Ura në Lanë) (km 0+740÷0+900); Punime ndërtimore Nyja 3 (Nënkalimi 4) (km 1+500-1+600), Punime ndërtimore Trup rrugë+rrugë urbane (km 0+900÷1+500); Punime për ndërtimin e ndricimit rrugor; Sistemi i kullimit të Ujrave Atmosferike si dhe Sinjalistika rrugore, siguria dhe siguria në punë.

Në mënyrë të detajuar janë përshkruar detyrat dhe përgjegjësitë e mbikqyrësit duke përcaktuar saktë dhe shumë qartë stafin e projektit , funksionet dhe detyrat e secilit prej tyre si dhe stafit mbështetës që bashkimi ynë i operatorëve vë në dispozicion të realizimit me sukses të këtij projekti.

Më pas vazhdohet me metodologjinë e mbikqyrjes , aktivitetet paraprake, fazën e mobilizimit, veprimtaria dokumentare dhe teknike, miratimi për kontraktorin, siguria në punë , deklaratat e qëllimit të kontraktorit. Vazhdohet me fazat e zbatimit dhe planin e kontrollit, testimet dhe monitorimin e punës për gërmimet, mbushje e trupit të rrugës, nënbaza dhe baza e rrugës, shtresat asfaltike, trotualet , veprat e artit, strukturat B/arme, punimet e kanalizimeve, punimet elektrike, ndricimi, sinjalistika rrugore. Po kështu në mënyrë të qartë përcaktohen takimet javore dhe mujore të rëndësishme këto për një mbarvajtje të mirë të punës.

Raportimi tek investitori në mënyrë të herpashershme dhe në mënyrë periodike zë një vend të rëndësishëm në Metodologji duke përcaktuar dhe përmbajtjen e raportit mujor duke u kujdesur që ky raport të jetë i plotë dhe gjithëpërfshirës përse i përket stafit të angazhuar nga Mbikqyrësi , raportimit mbi aktivitetet e realizuara në objekt për ndjekjen dhe kontrollin e punimeve, grafikut të shërbimit të mbikqyrjes , përshkrimit të detajuar të projekt zbatimit, organizimit të kontraktorit, progresit mujor, grafikut të ecurisë së punimeve, statusi financiar, volumeve të punimeve mujore, korenspondencave, problemeve gjatë zbatimit dhe konkluzioneve të raportit.

Metodologjia e propozuar përshkruan mënyrën e kontrollimit të kostove të projektit si dhe një rëndësi dhe vëmendje të vecantë i kushtohet mbrojtjes së mjedisit duke përgatitur një plan të kontrollit të mjedisit gjatë fazës së mobilizimit dhe kërkesës që ky plan të zbatohet nga kontraktori gjatë ndërtimit të objektit. Pas konfirmimit të përfundimit të punimeve për projektin me shkrim nga kontraktori do të kryhen testet e komisioneve për të siguruar që performanca e pajisjeve të instaluar , sistemeve të instaluar të jetë e kënaqshme duke plotësuar kërkesat në projekt dhe specifikimet. Dokumnetacioni i marrjes në dorëzim nga ana e

mbikqyrësit duhet të plotësohet konform dispozitave ligjore dhe jo vetëm si dhe jepet lista e dokumentave që duhen plotësuar dhe pasi ky dokumentacion grumbullohet e dokumentohet mbikqyrësi e paraqet pranë investitorit.

BOE IKN & Geosat shpk ka paraqitur në mënyrë shumë të qartë dhe të saktë grafikun e punimeve sipas fazave të punës dhe dorëzimit të projektit si dhe grafiku i organizmit të stafit kryesor. Këtu janë propozuar aktivitetet kryesore të detyrës , përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit duke transformuar kërkesat e termave të referencës një një plan pune konkret.

Në metodologji është përfshirë një numër i madh vizatimesh, grafikesh dhe tabelash të cilat e kanë kompletuar dhe qartësuar metodologjinë e propozuar.

Gjithashtu në mënyrë shumë të saktë është paraqitur edhe mënyra e kompozimit dhe struktura e stafit kryesor , lista e ekspertëve kryesorë, stafi mbështetës që është i shumtë në numër, me përvojë shumvjeçare në mbikqyrje si dhe personeli ekonomik administrativ . Është paraqitur CV e të dy kompanive të BOE ku tregohet eksperiencë shumvjeçare në mbikqyrje , konsulence e projektim.

Kjo metodologji meriton vlerësimin maksimal për mënyrën e saktë , profesionale dhe të qartë të mënyrës së paraqitjes së problemeve kryesore dhe përfaqësjes së propozuar. Kërkojmë një shpjegim se pse nga 30 pikë meritojmë vetëm 25.33 ndërkohë që shoqërinë Gjeokonsult&CO shpk e kemi vlerësuar maksimalisht. Mbi cilat kritere e kemi bërë këtë vlerësim??

- Nënkriteri tjetër i vlerësimit teknik-Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar

Sipas kërkesave të DST për këtë projekt kërkohet një listë me stafin kryesor , ,e inxhinierët e nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponentëve të saj , shoqëruar me CV e tyre, diplomën, kontratën e punës si dhe licencat profesionale për mbikqyrje. Sipas përmbajtjes së listës kërkohet që inxhinierët të kishin eksperiencë sipas fushave që mbulojnë pa përcaktuar se sa vite eksperiencë të përgjithshme dhe sa vite eksperiencë në fushën përkatëse (specifike) duhet të kishte secili.

Mbështetur në këto kërkesa inxhinieri i paraqitur sipas fushave të kërkuara nëse ka CV, diplomën , kontratën e punës dhe licencën personale për mbikqyrje plotëson kushtin për një vlerësim maksimal 50+10 dhe diferenca del nga oferta ekonomike.

Inxhinierët e paraqitur nga BOE IKN& Geosat shpk janë me eksperiencë të përgjithshme dhe specifike shumvjeçare me kualifikime sipas fushave të tyre me tituj shkencorë cka ben të drejtë kërkesën tonë për një vlerësim maksimal.

Tabela 3 Stafi i propozuar dhe kualifikimet e tyre

Nr	Emer Mbimer	Pozicioni	Kualifikimi i Përgjithshëm	Kualifikimi Specifik
1	A.C	Drejtues projekti Ing	28 vite	15 vite

		<i>Ndërtimi</i>		
2	<i>A..M</i>	<i>Mbikqyrës materialesh Ing Ndërtimi</i>	22 vite	12 vite
3	<i>I.A</i>	<i>Mbikqyrës për punimet e topografisë-Ing Topograf</i>	21 vite	7
4	<i>F.R</i>	<i>Mbikqyrës Gjeolog-Ing Gjeolog</i>	36 vite	13 vite
5	<i>K.Z</i>	<i>Mbikqyrës për punimet e sinjalistikës dhe sigurisë rrugore-Ing Mekanik</i>	32 vite	14 vite
6	<i>G.L</i>	<i>Mbikqyrës për punimet e rrjetit të ujës-jellës-Ing Hidroteknik</i>	20 vite	4 vite
7	<i>A.H</i>	<i>Mbikqyrës për punimet e gjelbërimit-Ing Mjedisi</i>	21 vite	5 vite
8	<i>K.G</i>	<i>Mbikqyrës për punimet elektrike-Ing Elektrik</i>	45 vite	10 vite
9	<i>B.C</i>	<i>Mbikqyrës për veprat e artit- Ing Ndërtimi</i>	<i>Mbi 45 vjet me titull Doktor i Shkencave</i>	27 vite

Përvec listës së stafit kryesor kemi paraqitur edhe listën e stafit mbështetës të cilët janë të lirë të mbështesin stafin kryesor në realizimin me sukses të kësaj kontrate. Si staf teknik mbështetës janë rreth 22 inxhinierë të specialiteteve të ndryshme shumica e të cilëve janë me kualifikime , me licenca personale me tituj shkencorë sipas fuushave të tyre. Gjithsej BOE IKN&Geosat ka rreth 49 të punësuar , mbi 95% të të cilëve janë inxhinierë me licencë personale.

Ju kujtojmë se me të njëjtat punë të ngjashme dhe staf BOE që ne përfaqësojmë është vlerësuar maksimalisht në procedura të tjera prokurimi ndërsa në këtë procedurë duke

mos pasur asnjë arsye për skualifikimin tonë por duke mos dashur të na shpallni fitues për këtë kontratë keni bërë një vendosje krejt subjektive të pikëve.

Ky numër dhe kjo cilësi e stafit tonë është më tepër nga të punësuarit e Gjeokonsult & Co shpk që ka marrë vlerësim maksimal nga ju. Mund të dimë mbi cilin kriter jeni bazuar për vlerësimin tuaj?? A mund të bëjmë një krahasim të kualifikimeve të stafëve të paraqitur nga BOE IKN&Geosat dhe atij të paraqitur nga Gjeokonsult&Co shpk?

II.7. Në datën 14.08.2019, nëpërmjet shkresës me nr.7620/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës me argumentat si më poshtë:

- *Arsyeja e vlerësimit me 9 pikë për punët e ngjashme për propozimin tuaj është e drejtë. Kjo për faktin se kompania e cila ka marrë pikët maksimale ka sjellë si punime të ngjashme më tepër mbikqyrje për objekte të infrastrukturës rrugore se sa kompania juaj. Për më tepër në punime të ngjashme ju keni përfshirë edhe Mbikqyrjen e objektit Mbrojtja dhe sistemi i pjesës së poshtme të digës së Qyrsaqit me vlerë 2,220,700 lekë pa tvsh e cila nuk konsiderohet si punim i ngjashëm.*
- *Lidhur me metodologjinë e propozuar jeni vlerësuar me 25.33 pikë pasi materiali i ofruar bazohet në statistika të përgjithshme mbi metodologjinë. Ndërkohë që operatori tjetër është më bindës në materialin e tij duke paraqitur më shumë detaje.*
- *Lidhur me kualifikimet e stafit kryesor të propozuar në përgjithësi mund të sqarojmë se vite total pune të eksperincës së stafit të paraqitur të operatorit tjetër janë 403 vite eksperincë ndërkohë që stafi juaj në total ka 270 vite eksperincë.*

II.8. Në datën 23.08.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr. 8043/1 prot., datë 29.08.2019, protokolluar me tonën me shkresën nr.1430/2 datë 02.09.2019 , me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.10. Në datën 07.10.2019 Komisioni i Prokurimit Publik pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues me vendimin KPP 641/2019 ka vendosur:

1. *Të pranojë ankesën e BOE “IKN” sh.p.k & “Geosat” shpk për procedurën e prokurimit “Shërbim Konsulence”, me Nr.REF-23485-05-23-2019, me objekt “Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrrrotullimi Shqiponja Loti 2”, me fond limit 10.700.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 12.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.*

2. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “IKN” sh.p.k & “Geosat” sh.p.k.*
5. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

II.11. Me shkresën nr.9057/2 prot., datë 16.10.2019, protokolluar me tonën nr.641/2 prot., datë 21.10.2019 autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar, njofton se ka zbatuar vendimin KPP 641/2019 datë 07.10.2019 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Shërbim Konsulencë”, me Nr.REF-23485-05-23-2019, me objekt “Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja Loti 2”, me fond limit 10.700.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 12.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.12. Me vendimin KPP.641/3/2019 datë 22.10.2019 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur heqjen e pezullimit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.13. Në datën 01.11.2019 autoriteti kontraktor ka vlerësuar propozimet ekonomike të pjesëmarrësve dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi rezultatet përfundimtare të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Geosat Group&IKN	6,206,400	97.066 pikë.
- Gjeokonsult&CO	10,691,597.64	87,609 pikë
- A&E Engineering	10,000,000	69,479 pikë
- Taulant	10,691,597.64	68.942 pikë

II.14. Në datën 07.11.2019, operatori ekonomik ankimues “Gjeokonsult” & Co” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me pretendimet si më poshtë:

- *Pas vendimit të KPP, KVO ka realizuar edhe një herë rivlerësimin e operatorëve ekonomikë duke interpretuar si urdhër vendimin e KPP dhe duke listuar tashmë në vendin e parë BOE Instituti i Konsulencës në Ndërtim IKN&Geosat shpk. KVO pretendon se duhet të vijonte me vlerësimin maksimal të BPE Geosat&IKN shpk por realisht ka ndodhur e kundërta pasi thjesht e ka vlerësuar me më shumë pikë se Gjeokonsult&Co shpk. Theksojmë gjithashtu se asnjë nga anëtarët e KPP që kanë dhënë këto rekomandime pikëzimi nuk është në profeison inxhinier ndërtimi apo inxhinier hidroteknik që të kenë aftësinë të gjykojnë drejt mbi një objekt të tillë cka*

e bën më dyshues procesin e vlerësimit. Për më tepër KVO nuk ka njoftuar në lidhje me rivlerësimin edhe pse ka detyrimin sipas ligjit që të njoftojë OE pjesmarrës pas cdo vlerësimi nga ata. AK në mungesë totale të transparencës në fshehtësi të plotë ka vlerësuar me pikë maksimale BOE Geosat&IKN shpk konkretisht me 20 pikë më shumë duke e renditur të parën në listë me 96,333. Shoqëria jonë Gjeokonsult&Co nuk është vënë në djeni në lidhje me vendimin e KPP as në lidhje me rivlerësimin e kryer nga AK por jemi njoftuar vetëm dy ditë para hapjes së ofertave ekonomike ku me anë të emailit na kërkohet që të paraqitemi pranë AK për të vijuar me procedurën e hapjes së ofertës ekonomike. Duke mos qenë të qartë me situatën kemi kërkuar në formë shkresore të njihemi me procesverbalin e mbajtur nga KVO në lidhje me rivlerësimin dhe vetëm atherë jemi pajisur me procesverbalin e rivlerësimit dhe vendimin e riklasifikimit. Në datën 01.11.2019 kemi marrë pjesë gjatë hapjes së ofertave ekonomike ku fitues është shpallur BPE Geosat&IKN me ofertën ekonomike 6,206,400 milion thuajse 50% e fondit limit të shpallur nga AK. Për sa më sipër vërehen qartazi shkeljet e kryera nga AK e theksojmë se procedura është kryer plotësisht jotransparente duke shkelur një nga parimet më të rëndësishme të LPP.

- Për shkaqet e mësipërme duke vënë re se ka problematika thelbësore të cilat duhen trajtuar me kujdes nga Komisioni i Ankesave pranë autoritetit bëjmë me dije si vijon:

Së pari sic është bërë publike dhe jemi njohur nëpërmjet medias ndodhemi përpara konfliktit të interesit ndaj nuk mund të lëmë pa e trajtuar në ankesë këtë rast të paprecedent. Në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin AK nuk konstaton konfliktin e hapur të interesit ndërmjet shoqërisë IKN dhe shoqërisë Salillari shpk. AK ka renditur në kundërshtim flagrant me ligjin të parin me pikë IKN për mbikqyrjen e punimeve në PP në fjalë duke mos konstatuar një fakt që dihej tashmë publikisht si dhe duke mbajtur të fshehur operatori faktin se firma ka lidhje financiare me zbatuesin e projektit Salillari pasi ajo po e mbikqyr autostradën Milot Morinë. Ligji përkatës ndalon në mënyrë të shprehur lidhjen mes mbikqyrësit të punimeve dhe zbatuesit.

Operatori Ekonomik IKN nuk duhej të merrte pjesë në PP në fjalë dhe se pasi ka marrë pjesë AK, ARRSH ka pasur detyrimin aktiv për ta skualifikuar menjëherë operatorin nga ofertimi dhe vijimi i mëtejshëm i procedurave të PP. Ligji nr.8402 datë 10.09.1998 për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit parashikon në fakt që kompania që mbikqyr punimet nuk duhet të ketë asnjë lidhje me kompaninë që zbaton projektin.

Duke qenë se Loti 2 i Unazës së Re do ndërtohet nga kompania Salillari dhe rezulton se IKN ka lidhje financiare pikërisht me kompaninë Salillari. IKN është nënkontraktuar për të mbikqyrur zbatimin e një kontrate nga Salillari dhe dy kompani të tjera për autostradën Milot-Morinë. Shoqëria IKN paguhet nga Salillari për këtë mbikqyrje pasi kontrata financohet 50% nga grupi i kompanive

ku bën pjesë Salillari dhe 50% nga shteti. Por ARSH ka vendosur ta shkelë këtë ligj duke e lejuar IKN të vijojë garën, madje edhe duke e renditur të parën. Kjo marrëdhënie kontraktuale duhet të kishte sjellë përjashtimin e menjëhershëm nga gara për mbikqyrje të punimeve të Unaza e Re të kompanive IKN&Geosat por në fakt edhe Autoriteti Rrugor edhe KPP kanë injoruar totalisht këtë konflikt të hapur interesi në kundërshtim me ligjin. Faktet tregojnë se OE IKN është i lidhur me subjektin që do të supervizojë dhe se kjo mund të përbëjë vepër penale. Zbatimi i kontratës për segmentin Milot Morinë bëhet nga kompania Dolsar Enginrrting Inc Co e cila ka emëruar si nënkontraktor pikërisht IKN. Neni 3/2 i kontratës shërbime konsulence për inxhinier të pavarur për projekti e koncensionit të autostradës Milot Morinë thekson se financimi i këtij objekti kryhet 50% me fonde të buxhetit të shtetit dhe 50% nga kompania koncesionare.

Në nenin 26 të kontratës në fjalë thuhet se kontraktori (Dolsar Enginrrting Inc Co) do të nënkontraktojë deri në masën 20% të shërbimit nënkontraktorin IKN. Bëhet fjalë për rreth 100 milion lekë të reja, dhjetë herë më shumë se vlera e kontratës për unazën e re. Pra Salillari ka lidhje të qarta ekonomike pasi paguan IKN për mbikqyrjen e kontratës për autostradën Milot Morinë. IKN kërkon që të mbikqyrë edhe punimet e Salillarit në unazën e re gjë që ndalohet me ligj. Për sa më sipër në rast se do të vijohet më tej me lidhjen e kontratës do të ishim përpara paligjshëmrisë deri në konsumim të veprës penale dhe do të ishim përpara shkeljeve të parimeve mbi të cilat sot është ndërtuar një praktikë e konsoliduar për procedurat e prokurimit publik.

Gjëndja e konfliktit të interesit në rastin në fjalë provuar me fakte dhe prova është gjëndja e konfliktit ndërmjet mbikqyrësit dhe zbatuesit të punimeve të ndërtimit dhe interesat e tyre privatë janë ndërthurur në nivel të lartë ekonomik në të cilën IKN nuk do mundej kursesi ti dilte kundër edhe nëse do të gabonte apo do të abuzonte shoqëria Salilalri , kjo sjell si pasojë ndikimin e fuqishëm tek njëra tjetra në raporet e tyre ekonomike e për pasojë në një ndikim të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tyre publike.

Natyra e prokurimit publik kërkon domosdoshmërisht kryerjen në mënyrë të drejtë të detyrave dhe përgjegjësi të materializuara në vendimarrje, në të cilat dy operatorë duhet të veprojnë në përputhje me ligjin, ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim në afat, në mbrojtje në cdo rast të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku janë kontraktuar, të shtetit në përgjithësi dhe të buxhetit të shtetit mbledhur nga taksapaguesit. Vijimi i procedurës së lidhjes së kontratës në rastin në fjalë do të sjellë si pasojë kryerje në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe e përgjegjesive.

- Së dyti vlera e ofretës së shpallur fituese është në kundërshtim të plotë me VKM nr.354 datë 11.05.2016 Për miratimin e manulait të tarifave për shërbime në

planifikim projektim mbikqyrje dhe kolaudim. Oferta e IKN është nën vlerën e përcaktimeve të normuara tashmë në këtë VKM.

Në kushtet kur oferta nuk është në përputhje me ligjin sjell një ofertë të paligjshme dhe një garë të paligjshme. Pavarësisht vlerësimit të KPP, KVO duhej të shqyrtonte me kujdes dhe të përlllogariste me kujdes ofertën e të gjithë operatorëve pa u frikësuar për të shtuar në mënyrë fiktive pikët në renditjen e operatorëve.

Vlerësimi i ofretave nuk është kryer duke aplikuar formulën e vlerave minimale , bashkimi i operatorëve ekonomikë Geosat&IKN shpk ka paraqitur ofertë të papërgjegjshme dhe dukshëm nën kufirin e përcaktuar nga legjislacioni i posacëm në fuqi Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim, e cila është e detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomikë pasi ky legjislacion nuk lë në diskrecionin e një autoriteti kontraktor të pranojë argumentat për elementët e vecantë të ofertës ekonomike të opertaorëve përsa kohë që ajo është jashtë kufijve minimalë dhe maksimalë të tarifave. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike operatori ekonomik Geosat&IKN shpk rezulton se ka ofertuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi 6,206,400 lekë pa tvsh vlerë e cila nga përlllogaritjet e kryera është shumë herë më e ulët se kufiri minimal e për rrjedhojë kjo ofertë nuk është në përputhje me VKM nr.354 datë 11.05.2016 dhe rekomandimin e APP.

Referuar sa më sipër kuadri ligjor në fuqi ka vendosur tarifa minimale dhe maksimale për shërbimin e konsulencës e mbikqyrjes të cilat duhet të mbahen në konsideratë nga operatorët ekonomikë në këto procedura. Pra pas hapjes së ofretave ekonomike autoriteti kontraktor duhet të kishte skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik Gesoat&IKN si ofertë e papërgjegjshme dhe të shpallte fitues operatorin ekonomik Gjeokonsult &Co i cili ka paraqitur ofertë në përputhje me VKM nr.354.

Vetë AK nuk i është përmbajtur shënimit të bërë vetë në shtojcën 4 struktura e propozimit ekonomik të DST ku shprehimisht thuhet: AK në përcaktimin e fondit limit për këtë procedurë prokurimi është bazuar në venidmin nr.354 datë 11.05.2016 Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim dhe objekti është i grupit të tretë tarifar.

Në lidhje me të tilla raste ka një praktikë të konsoliduar nga KPP. Bashkëlidhur ankesës gjeni vendimin e KPP nr.352/2018 që trajton një rast të ngjashëm.

Për sa më sipër kërkojmë:

- *Përjashtimin përfundimtar të operatorit IKN nga procedura e prokurimit të sipërcituar.*

- Detyrimin e KVO të vlerësojë në mënyrë përfundimtare ofertat e operatorëve duke pranuar ofertën e operatorit ekonomik Gjeokonsult&Co shpk si ofertë të suksesshme.

II.15. Në datën 14.11.2019 me shkresën nr. 10240 prot operatori ekonomik ankimues “Gjeokonsult&Co” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor me argumentat si vijon:

- Sa i përket pretendimit për konfliktin e interesit KSHA argumenton: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të tenderit rezulton se BOE Geosat&IKN ka plotësuar deklaratën mbi konfliktin e interesit sipas ligjit 9367 datë 07.04.2005 Për parandalimin e konfliktit të interesit. Ky veprim procedural i mundëson operatorit ekonomik (bashkimit) të marrë pjesë në tender duke ju nënshtruar detyrimeve të përcaktuara nga neni 45 pika 2/e dhe 47 të LPP mbi informacionin e rremë. Nga verifikimi i dosjes së tenderit nuk rezulton që gjatë procedurës dhe deri në momentin e publikimit në media të këtij fakti të jetë administruar ndonjë informacion lidhur me të dhëna të rreme të paraqitura nga BOE Gesoat Group&IKN.

Duke marrë shkas nga publikimet në media dhe ankimi juaj AK ka marrë në shqyrtim faktet e pretenduara. Nga verifikimi jo formal (për shkak të mungesës së aktit dhe burimit të informacionit) i pjesës së kontratës Nr.508/4 datë 14.06.2017 me objekt “Shërbim konsulence për inxhinier të pavarur për projektin e koncesionit të autostradës Milot Morinë” publikuar në media rezulton se subjekti IKN shpk është nënkontraktuar për kryerjen e 20% të shërbimeve nga grupimi ekonomik i përfaqësuar nga Dolsar Engineering Inc and Co. Në këtë kontratë rezulton që investitor janë shteti shqiptar i përfaqësuar nga MEI në rolin e AK në kontratën e koncesionit dhe grupimi ekonomik i përfaqësuar nga Dolsar Engineering Inc and Co në rolin e koncesionarit.

Nga analiza e këtyre marrëdhënieve juridike vlerësojmë se bashkimi i operatorëve ekonomikë Geosat Group&IKN nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit për këto arsye.

Kontrata e shërbimit të konsulencës ndërmjet shoqërisë IKN shpk dhe grupimit ekonomik i përfaqësuar nga Dolsar Engineering Inc and Co është marrëdhënie rasti në kategorinë e kontratave civile që i përket objektit të veprimtarisë tregëtare të këtij subjekti sikundër është edhe kontrata e ofruar në tender nga ARSH. Kjo kontratë nuk mund të përfshihet në kategorinë e marrëdhënieve juridike me operacione tregëtare e financiare për zotërim aksionesh , dhënie të huave apo pjesëmarrje në fitime të cilat do të krijonin pa dyshim premisat për një situatë të konfliktit të interesit dhe do të detyronin ARSH të merte masat e nevojshme korrigjuese. Subjektet që ushtrojnë veprimtari mbikqyrëse në fushën e ndërtimit janë të detyruara të zbatojnë ligjet e shtetit shqiptar, kodin profesinonal dhe

udhëzimet e punëdhënësit në marrëdhëniet kontraktore. Fakti që shoqëria IKN është njëkohësisht e kontraktuar për mbikqyrje të objekteve të ndryshme nuk prezumon apriori se do të veprojë në dëm të punëdhënësit të tij ARRSH vetëm sepse zbatuesi i punimeve në këtë kontratë është pjesmarrës në grupin e investitorëve në kontratën tjetër.

- *Në lidhje me vlerën e ofertës së renditur në vendin e parë ju sqarojmë se vendimi i KVO për renditjen e ofertës ekonomike Geosat Group&IKN është i drejtë dhe i bazuar në parashikimet e nenit 37 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 si dhe qëndrimin e APP për kontratat e konsulencës. Po ashtu ky vendim vjen edhe në respektim të qëllimit të ligjvënësit shprehur në pikën 2/b të nneit 1 të LPP i cili përcalton se: Qëllimi i ligjit është të sigurojë mirpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale.*

Sa më sipër ankesa nuk pranohet.

II.16. Në datën 22.11.2019, pala ankimuese “Gjeokonsult&Co” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.17. Nëpërmjet shkresës me nr. 10924/1 prot datë 04.12.2019 protokolluar me tonën me nr.1789/2 datë 10.12.2019 dhe nr.580/1 prot datë 27.01.2019 protokolluar me tonën me nr.1789/5 datë 27.01.2020 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Gjeokonsult&CO” shpk mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Geosat Group &IKN” me argumentat se “Së dyti vlera e ofertës së shpallur fituese është në kundërshtim të plotë me VKM nr.354 datë 11.05.2016 Për miratimin e manulait të tarifave për shërbime në planifikim projektim mbikqyrje dhe kolaudim. Oferta e IKN është nën vlerën e përcaktimeve të normuara tashmë në këtë VKM.

Në kushtet kur oferta nuk është në përputhje me ligjin sjell një ofertë të paligjshme dhe një garë të paligjshme. Pavarësisht vlerësimit të KPP, KVO duhej të shqyrtonte me kujdes dhe të përllogariste me kujdes ofertën e të gjithë operatorëve pa u frikësuar për të shtuar në mënyrë fiktive pikët në renditjen e operatorëve.

Vlerësimi i ofretave nuk është kryer duke aplikuar formulën e vlerave minimale , bashkimi i operatorëve ekonomikë Geosat&IKN shpk ka paraqitur ofertë të papërgjegjshme dhe dukshëm nën kufirin e përcaktuar nga legjislacioni i posacëm në fuqi Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim, e cila është e detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomikë pasi ky legjislacion nuk lë në diskrecionin e një autoriteti kontraktor të pranojë argumentat për elementët e vecantë të ofertës ekonomike të opertaorëve përsa kohë që ajo është jashtë kufijve minimalë dhe maksimalë të tarifave. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike operatori ekonomik Geosat&IKN shpk rezulton se ka ofertuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi 6,206,400 lekë pa tvsh vlerë e cila nga përllogaritjet e kryera është shumë herë më e ulët se kufiri minimal e për rrjedhojë kjo ofertë nuk është në përputhje me VKM nr.354 datë 11.05.2016 dhe rekomandimin e APP.

Referuar sa më sipër kuadri ligjor në fuqi ka vendosur tarifa minimale dhe maksimale për shërbimin e konsulencës e mbikqyrjes të cilat duhet të mbahen në konsideratë nga operatorët ekonomikë në këto procedura. Pra pas hapjes së ofertave ekonomike autoriteti kontraktor duhet të kishte skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik Gesoat&IKN si ofertë e papërgjegjshme dhe të shpallte fitues operatorin ekonomik Gjeokonsult &Co i cili ka paraqitur ofertë në përputhje me VKM nr.354.

Vetë AK nuk i është përmbajtur shënimit të bërë vetë në shtojcën 4 struktura e propozimit ekonomik të DST ku shprehimisht thuhet: AK në përcaktimin e fondit limit për këtë procedurë prokurimi është bazuar në vendimin nr.354 datë 11.05.2016 Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim dhe objekti është i grupit të tretë tarifar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr.580/1 prot datë 27.01.2019 protokolluar me tonën me nr.1789/5 datë 27.01.2020, KPP konstaton se përllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga ky i fundit është bërë, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

III.1.3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” sipërcituar në nenin 1 të tij “Fusha e Veprimit” parashikon shprehimisht se: Ky manual i tarifave vlen për llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet e palnifikimit, projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit të kryera nga arkitektët dhe inxhinierët

(porosimarrës) të financuara me fonde publike, të financuara me fonde publike, të përfshira në listën e punimeve të këtij manuali.

Ndërsa në nenin 7 të saj parashikohet shprehimisht se: Tarifat për shërbimet duhet të jenë në një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale të përcaktuara në këtë manual në përputhje me LPP. Pika 3 e nenit 7 parashikon se: Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim tarifat edhe mund të jenë më të ulëta se sa taifa minimale të specifikuar nga ky manual.

III.1.4. Në Rekomandimin Nr. 5585 Prot datë 25.07.2017 të APP-së; “Rekomandim mbi menyrën e percaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, parashikohet si më poshtë:

- Per shërbimet e parashikuara në vendimin e sipercituar (Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016), APP rekomandon që, krahas perlllogaritjes së fondit limit (i cili perlllogaritet nisur nga perqindja maksimale e lejuar), behet perlllogaritja e vlerës minimale të lejuar (e cila perlllogaritet nisur nga p erqindja minimale e lejuar), në varesi të kategorisë dhe grupit tarifor , ku ben pjese objekti i prokurimit
- Në nenin 7, pika 3, të vendimit të sipercituar, parashikohet se: "Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat edhe mund të jenë më të ulëta sesa normat minimale, të specifikuar nga ky manual".
- Në këtë kontekst rekomandojmë që, në rastet kur nuk dokumentohet rrethana të jashtëzakonshme, autoritetet kontraktore gjatë vlerësimit të ofertave, duhet t'i referohen vlerës minimale të perlllogaritura për secilin rast, në bazë të parashikimeve në VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim".
- Në paraqitjen e ofertave në këtë lloj procedure prokurimi, operatorët ekonomikë duhet të mbajnë në konsideratë edhe vlerat minimale të perlllogaritura nga autoritetet kontraktore në zbatim të VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim".

III.1.5. Qëllimi i VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” është që të mbrojnë profesionet të cilat merren me planifikim territori, projektim, mbikëqyrje e kolaudim, pra lidhet me punën intelektuale që do të bëhen, duke dhënë një punë cilësore, por me një vlerë mbi minimumin e lejuar të përcaktuar me një vendim të posaçëm.

Kjo VKM e posaçme ka për qëllim të zgjidhë situatën e vështirë të krijuar në afrimin dhe përzgjedhjen e personave fizikë, apo juridikë të interesuar, të kontraktohen për shërbimet e kërkuara, pasi shpesh ka rezultuar edhe me uljen e cilësisë së shërbimit të ofruar.

Efekti i zbatimit të kësaj VKM është rritja e cilësisë së produktit të marrë në fushën e studimit, projektimit, drejtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, nëpërmjet afrimit të profesionistëve të dalluar, duke përafruar nivelin e pagave që ato t'i përgjigjen realitetit të tregut të sotëm.

Gjithashtu, referuar edhe frymës së legjislacionit të posaccëm në fuqi, në rast se nuk zbatohet kjo VKM e cila ka dalë për qëllim të posaçëm për të mbrojtur punën intelektuale që bëhet në fushën e këtyre shërbimeve, atëherë kjo VKM nuk ka më asnjë vlerë dhe do të humbiste qëllimin për të cilin ka dalë për zbatim, sepse vetëm nëse do të mbeteshim tek argumentimi i analizës së kostos nëse ajo do të rezultonte anomalisht e ulët, atëherë kjo analizë do të ishte shumë subjektive, aq më tepër kur autoriteti kontraktor mund të kërkonte sqarime nga operatorët ekonomikë nëse pas aplikimit të formulës për ofertën anomalisht të ulët, mbi ofertat brenda kufijve ligjorë, do të rezultonte se një apo më shumë oferta janë anomalisht të ulta.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit “propozimi ekonomik” të operatorit ekonomik “Geosat Group & IKN” shpk, rezulton se vlera e ofertuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi është 6,206,400 lekë pa tvsh. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të sipërcituar, rezulton se vlera minimale e mbikëqyrjes e përlogaritur për objektin “*Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja Loti 2*” të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është më e madhe se vlera e ofertuar nga operatori ekonomik “Geosat Group&IKN” shpk. KPP gjykon se vlera e ofertuar nga operatori ekonomik “Geosat Group&IKN” shpk nuk është në përputhje me VKM nr. Nr.354 datë 11.05.2016 “*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*”, dhe rekomandimin e APP-së, pasi është më e ulët se vlera minimale e përlogaritur nga autoriteti kontraktor për realizimin e kësaj kontrate.

III.1.7. Referuar sa më sipër KPP gjykon se duke qenë se kuadri ligjor në fuqi ka vendosur tarifa minimale dhe maksimale për shërbimet e mbikëqyrjes dhe kolaudimit duhet të mbahen në konsideratë nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në këto procedura.

Në këtë kuptim, Komisioni sqaron se është detyrë e operatorëve ekonomikë të garantojnë që oferta e paraqitur të jetë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, operatori ekonomik “Geosat Group&IKN” shpk ka ofertuar me një vlerë e cila rezulton të jetë nën vlerën minimale të lejuar të përlogaritur nga autoriteti kontraktor për kryerjen e këtij shërbimi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Gjeokonsult & Co” shpk mbi kualifikimin e shoqërisë “Geosat Group&IKN” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër gjendja faktike dhe

juridike e operatorit ekonomik “Geosat Group&IKN” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gjeokonsult” & Co” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr.REF-23485-05-23-2019, me objekt “*Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja Loti 2*”, me fond limit 10.700.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 12.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Geosat Group” & “IKN” sh.p.k, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Gjekonsult & Co” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1789 Protokolli; Datë 22.11.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

